



Data: 29/07/2019

Ref.: 1348/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

#### V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” në nivel institucional.
- II. Riakreditohen programet e studimit:
  - Administrim biznesi, BSc, 180 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 150 studentë për vit akademik.
  - Menaxhment ndërkombëtar, BSc, 180 ECTS për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 200 studentë për vit akademik.
  - Juridik, LLB, 240 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 180 studentë për vit akademik.
  - Dizajn Softueri, BSc, 120 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 180 studentë për vit akademik.
  - Teknologji informative dhe komunikim, BSc, 120 ECTS, për periudhën 01.10.2019 – 30.09.2022, me nga 180 studentë për vit akademik.
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën tjetër të riakreditimit institucional.
- IV. Nuk akreditohet programi i studimit:
  - Juridik kushtetues administrativ, LLM, 60 ECTS

- V. Obligohet Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

I. Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" ka parashtuar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" më datë 15.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Stephen Adam, Prof. Dr. Magdalena Platis, Prof. Dr. Kristiina Tonnison, Prof. Dr. Peeter Normak, Prof. Dr. Johannes Falterbaum, Mr. Mihai Adrian Vilcea (Student Expert).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", nga gjithsej 11 kapituj të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit i përmbush standardet si vijon: nuk i përmbush 6 kapituj, i përmbush pjesërisht 2 kapituj, dhe e përmbush substancialisht 1 kapitull.

Në kapitullin e parë, lidhur me misionin publik dhe objektivat institucionale, i cili nuk përmbushet, ekipi i ekspertëve ka vërejtje në formulimin e deklaratës së misionit dhe planit strategjik, të cilën në vlerësimin e 2015, ekspertët kishin rekomanduar ta specifikonin, ndërsa përgjigja e Universitetit të Prizrenit në raportin e vetëvlerësimit kishte qenë se besojnë se misioni dhe vizioni i tyre i përshtatet shumë mirë kapaciteteve dhe nevojave tona. Ekipi i ekspertëve konsideron se deklarata e misionit mbetet tepër e gjerë dhe nuk fokusohet në nevojat e lokalitetit dhe rajonit. Është e paqartë dhe shumë e përgjithësuar dhe mundëson çfarëdo dhe çdo program të ri të propozuar të përshtatet në të. Kjo mohon dhe shkel standardet e AAK-së (standardet e AKA 1.1-1.5 dhe treguesit e performancës 1.1-1.4). Gjithashtu, ekspertët kanë përsëri vërejtje për kritikën e mëparshme lidhur me tabelën organizative, sepse ajo nuk është e lexueshme për shkak se është shumë e vogël në versionin elektronik të printuar, ndërsa në ueb faqe nuk mund të hapet as në gjuhën lokale e as në atë angleze. Në takimin e parë me menaxhmentin e lartë të institucionit, kishte shumë pengesa nga nevoja për të përkthyer vazhdimisht nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Sa i përket kapitullit të dytë, kuptohet se plani i ri strategjik është hartuar dy muaj më parë, që nuk është në përputhje me periudhën kohore të cilën e mbulon ky dokument (2018-2022), gjë që tregon se është produkt i konsultimeve intensive. Po ashtu aty përsëritet deklarata e misionit dhe vizionit. Ekipi e ekspertëve më tutje ka vërejtje se, edhe pse ekziston tabela e planit të veprimit, në të ka mjaft paqartësi dhe përdoren shkurtesa të cilat nuk kanë sqarime për domethënien e tyre. Dokumenti i planit strategjik nuk i përfshin kostot e sakta, kriteret dhe data e sakta për progresin monitorues. Përveç kësaj, tabela e planit të veprimit nuk lidhet dhe nuk reflekton të gjitha synimet e dhëna në listë. Edhe këtu ka vërejtje se nuk janë të gjitha dokumentet në gjuhën angleze që pamundëson ekspertët të kompletojnë raportin.

Sa i përket kapitullit të tretë (planifikimit financiar), vërejtjet e ekspertëve janë se në raportin e brendshëm të UPZ aspektet financiare janë trajtuar shumë shkurtimisht, buxheti për vitet e ardhshme është i njëjtë me vitin aktual, dhe ky aspekt u ka ofruar një pasqyrë të qartë se nuk është planifikuar ndonjë veprim real dhe konkret.

Kapitulli i katërt trajton kodin etik, për të cilin ekspertët vlerësojnë se është gjithëpërfshirës dhe ka disa rregullore që kufizojnë lirinë e fjalës për stafin akademik si dhe për studentët. Kjo për arsye se komiteti Etik propozohet nga Rektori dhe aprovet nga Komiteti Drejtues, procedurë kjo e cila nuk ofron pavarësinë e komitetit.

Sa i përket kapitullit të pestë, sigurimit të cilësisë, ekspertët vërejnë se edhe pse ekziston zyra për sigurim të cilësisë, ende nuk ka ndonjë manual dhe as komision për sigurim të cilësisë, por kjo zyrë përmban vetëm një person. Në fakt, sigurimin i cilësisë bëhet nga persona dhe trupa të ndryshëm që kanë edhe disa funksione tjera.

Në kapitullin e pestë trajtohet mësimdhënia dhe mësimnxënia, ekspertët theksojnë se as nga raporti i vetë vlerësimit e as nga vizita, nuk mund të identifikonin se si UPZ i monitoron politikat dhe procedurat. UPZ nuk ka zhvilluar ende ndonjë sistem të brendshëm për treguesit e cilësisë, dhe vlerësimi i vetëm është përmes standardeve të AKA. Po ashtu, ekspertët nuk patën mundësi të vlerësonin disa standarde për shkak të mungesës së dokumenteve.

Sa i përket kapitullit të shtatë i cili trajton hulumtimin, ekspertët vërejnë se UPZ nuk ka ndonjë plan të qartë por që plani i zhvillimit të hulumtimit është inkorporuar në dy dokumente kryesore "Strategjia e Zhvillimit të Përgjithshëm 2018-2022" dhe "Strategjia e Sigurimit të Cilësisë". Nuk janë të cekura shpenzimet e planifikuara për hulumtime. Nga dokumentet e ofruara, është e vështirë të veçohet një planifikim i zhvilluar. "Strategjia e Sigurimit të Cilësisë" e vitit 2013 përmban pak kërkime, vetëm një deklaratë për mobilitetin ndërkombëtar të stafit.

Në kapitullin e nëntë, ku trajtohet administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse, ekspertët kanë vërejtje se në ueb faqe nuk mund të gjenden informacione për pranimin e studentëve. Pastaj ekspertët kishin vështirësi për informimin lidhur me numrin e studentëve, sepse shifrat ishin të ndryshme në raport, në vizitë si dhe në sistem elektronik. Vërejtje tjetër është se regjistrimi i studentëve ka vazhduar edhe pas fillimit të vitit akademik. Në disa fakultete infrastruktura nuk është në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar. Ka vërejtje nga ana e studentëve se nuk kanë përkrahje për aktivitete jashtë kurrikulare.

Në kapitullin e dhjetë – burimet e mësimit dhe objektet, ekspertët vlerësojnë se kushtet e bibliotekës nuk janë të mjaftueshme, nuk ka libra e revista të mjaftueshme, si dhe buxheti i bibliotekës është i vogël. Sipas ekspertëve, studentët kanë nevojë për përmirësim të përgjithshëm të mjedisit universitar, më shumë hapësira fizike dhe kanë nevojë për më shumë tekste në gjuhën angleze. Gjithashtu qasja në revista është mjaft e dobët.

Sa i përket kapitullit të njëmbëdhjetë – bashkëpunimi institucional, ekspertët konstatojnë se UPZ nuk ka ndonjë bord këshillues në nivel lokal apo rajonal i cili do të mbante bashkëpunimin me akterët e jashtëm. Plani Strategjik i UPZ 2018-2022 tregon se “internacionalizimi” është një prioritet. Në planin strategjik të disa fakulteteve përmendet hapja e zyrave, rritja e projekteve, si dhe anëtarësimi i organizatat ndërkombëtare, por nuk ofrohen detaje të mjaftueshme, si dhe mungojnë llogaritjet e kostove.

Në lidhje e akreditimin e programit Juridik kushtetues administrativ, LLM, 60 ECTS, ekipi i ekspertëve konstaton se ky program nuk i përmbush shumicën e standardeve në 7 kapituj të Manualit të akreditimit si vijon: 2 kapituj nuk i plotësojnë standardet, 1 kapitull i plotëson pjesërisht, 2 kapituj i plotësojnë substancialisht, ndërsa nga 2 kapituj nuk mund të vlerësohet, sepse programi ka aplikuar për akreditim për herë të parë (studentë ekzistues dhe menaxhimi i cilësisë nuk mund të vlerësohen).

Në kapitullin e parë, që trajton misionin, objektivat dhe administrimin, ekipi i ekspertëve thekson se nuk kanë marrë shpjegime konkrete se në Kosovë ekziston kërkesa për një program të tillë, sepse në vend nuk ka nevojë për një numër aq të madh të ekspertëve të së drejtës kushtetuese, marrë parasysh për numrin e madh të programeve të nivelit master në juridik.


Kapitulli i gjashtë trajton hulumtimin, dhe këtu ekspertët kanë vërejtje se meqenëse në raportin e vetëvlerësimit nuk kanë pasur informata të qarta për aktivitetet kërkimore të UPZ, ata kanë kërkuar që ato tu dërgohen. Mirëpo, ata kanë pranuar një dokument i cili ka përfshirë një koleksion të çrregullt që i referohet ueb faqeve të ndryshme të kongreseve dhe shoqatave të ndryshme. Kjo ka qenë e padobishme dhe nuk paraqet punën kërkimore të universitetit. Po ashtu disa informacione të ofruara nga fakulteti, nuk kanë qenë të përkthyer në gjuhën angleze, ose nuk u është cekur autori.

Në kapitullin e shtatë, ekspertët kanë vërejtje në mungesën e librave të mjaftueshëm, posaçërisht atyre për ligjet e Kosovës.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

